

Leje e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore: Çfarë duhet të dinë punëdhënësit

Ndryshimet e reja në ligjin e qytetit të Nju-Jorkut “Për kohën e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore” (ligji “Për lejen e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore”) hyjnë në fuqi më datë 30 shtator 2020 dhe 1 janar 2021. Nëse jeni një punëdhënës në sektorin privat ose jofitimprurës apo nëse keni punësuar punëtor/e shtëpiak/e në qytetin e Nju-Jorkut, lexoni këtë fletë informative¹ për të kuptuar përgjegjësitë e punëdhënësit. Sipas kuptimit të ligjit, punëmarrësit e mbuluar kanë të drejtën ta përdorin këtë leje:

- për arsye shëndetësore, ku përfshihet kujdesi dhe trajtimi për veten ose për një anëtar të familjes; dhe
- për arsye sigurie², ku përfshihet kërkimi i ndihmës ose marrja e masave të tjera të sigurisë nëse punëmarrësi ose një anëtar i familjes mund të jetë viktimë e një akti apo kërcënimi të dhunës në familje, kontakti seksual kundër dëshirës, përndjekjes apo trafikimit të qenieve njerëzore.

Të gjithë punëdhënësit në sektorin privat dhe jofitimprurës dhe punëdhënësit e punëtorit/es shtëpiak/e duhet të japin leje për arsye sigurie dhe shëndetësore

Numri i punëmarrësve	Të ardhurat vjetore të punëdhënësit	Totali i orëve të lejes për çdo vit kalendarik*	Leje e paguar ose e papaguar
1 - 4	Më pak se 1 milion \$	Deri në 40 orë	E papaguar
	hyn në fuqi më datë 1.1.2021: 1 milion dollarë ose më shumë	Deri në 40 orë	E paguar
5 apo më shumë të punësuar nga punëdhënës në sektorin privat ose jofitimprurës OSE hyn në fuqi më datë 30.9.2020: 1 apo më shumë punëtor/e shtëpiak/e të punësuar nga punëdhënës familjarë	N/A	Deri në 40 orë	E paguar
hyn në fuqi më datë 1.1.2021: 100 apo më shumë të punësuar nga punëdhënës në sektorin privat ose jofitimprurës ose nga punëdhënës të punëtorit/es shtëpiak/e	N/A	Deri në 56 orë	E paguar

*Shënim: “Vit kalendarik” është çdo periudhë kohore 12-mujore e rregullt dhe e vazhdueshme e përcaktuar nga punëdhënësi.

Nëse ju kërkohet të jepni leje të paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore, ju duhet t’i paguani punëmarrësit sipas tarifës së tyre të zakonshme për orë dhe jo më pak se paga minimale aktuale.

Nëse keni një politikë ekzistuese sipas së cilës punëmarrësve u lejohet përdorimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore, politika juaj në fjalë duhet të përmbushë ose të tejkalojë kërkesat e ligjit.

Punëmarrësit që nuk mbulohen nga ligji

Nuk jeni i detyruar të ofroni leje për arsye sigurie dhe shëndetësore për punëmarrësit e mëposhtëm:

- Studentët në programet federale të punës dhe studimit
- Punëmarrësit puna e të cilëve kompensohet nga programe të kualifikuara për bursa studimi
- Punëmarrësit në agjenci qeveritare
- Fizioterapistët, ergoterapistët, ortofonistët, audiologët të cilët janë të licencuar nga Departamenti i Arsimit i shtetit të Nju-Jorkut (nëse marrin përsipër detyra me vullnetin e tyre, përcaktojnë vetë orarin e tyre të punës, kanë mundësi të refuzojnë ose pranojnë çdo detyrë që iu është referuar dhe paguhen me një pagë minimale për orë pune që është të paktën sa katërfishi i pagës federale minimale)
- Kontraktorët e pavarur që nuk janë në pajtueshmëri me përkufizimin e një punëmarrësi sipas ligjit “Për punën” të shtetit të Nju-Jorkut
- Pjesëmarrësit në programet e përvojës së punës ((Work Experience Programs)
- Disa punëmarrës të caktuar që janë objekt i një kontrate kolektive³

Njoftim për të drejtat e punëmarrësit

Secili punëmarrës i mbuluar duhet të pajiset nga ana juaj me një njoftim me shkrim për të drejtën e tyre për leje për arsye sigurie dhe shëndetësore, ku përfshihet akumulimi dhe përdorimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore, e drejta për të depozituar një ankesë dhe e drejta për mospenalizim. Në njoftim duhet të deklarohet data e fillimit dhe e përfundimit të vitit tuaj kalendarik. Punëmarrësit gëzojnë të drejtën për ta marrë këtë njoftim në gjuhën angleze dhe në gjuhën e tyre të parë, nëse disponohet një version i përkthyer në faqen e internetit të DCWP-së nyc.gov/workers. Ju duhet gjithashtu të afishoni njoftimin në vendin e punës, në një ambient të dukshëm dhe të aksesueshëm nga të gjithë punonjësit.

¹ Vini re datën në pjesën e pasme. Mbrojtësi i Konsumatorit dhe Punonjësve i qytetit të Nju-Jorkut (Department of Consumer and Worker Protection, DCWP) do të përditësojë këtë fletë sipas rastit. Monitoroni faqen e internetit nyc.gov/workers për përditësime.

² Dispozitat për lejen për arsye sigurie hynë në fuqi më datë 5 maj 2018. Punëdhënësve nuk u kërkohet të japin kohë pushimi shtesë për lejen për arsye sigurie; por, ata duhet të lejojnë punëmarrësit të përdorin lejen e akumuluar për qëllime të lejes për arsye sigurie.

³ Punëmarrësit nuk mbulohen nëse kontrata përjashton shprehimisht zbatimin e dispozitave të ligjit dhe ofron përfitime të krahasueshme. Sidoqoftë, për punëmarrësit në sektorin e ndërtimit ose atë ushqimor të mbuluar nga një kontratë kolektive, ligji nuk gjen zbatim nëse kontrata përjashton shprehimisht zbatimin e dispozitave të ligjit.

Akumulimi dhe përdorimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore

Ju duhet:

- Të lejoni punëmarrësit e mbuluar të akumulojnë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore që në momentin e fillimit të marrëdhënies së tyre të punës. Norma minimale e akumulimit është 1 orë për çdo 30 orë të kryera pune.
- Të lejoni punëmarrësit të përdorin lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore menjëherë teksa ajo akumulohet.
- Të pajisni punëmarrësit, në çdo periudhë pagese, me një dokument me shkrim ku të pasqyrohen orët e përdorura, të akumuluar dhe të mbetura të lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore.

Përrjashtim: Nëse një punëmarrës mbulohet nga një kontratë kolektive e hyrë në fuqi më datë 1 prill 2014, akumulimi i lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore sipas ligjit fillon në datën e skadimit të kontratës.

Mbajtja e të dhënave

Ju duhet të ruani dhe të mbani evidencat që dokumentojnë pajtueshmërinë me ligjin për të paktën tre vite. Ju duhet të ruani konfidencialitetin për të gjitha informacionet e lidhura me motivet se përse punëmarrësi ka marrë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore, me përjashtim të rasteve kur punëmarrësi lejon shpërndarjen e informacionit ose kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji. Të dhënat duhet t'i vini në dispozicion të Mbrojtësit të Konsumatorit dhe Punonjësve të qytetit të Nju-Jorkut brenda një afati të dakordësuar kohore pas marrjes së njoftimit.

Njoftimi paraprak

Nëse nevoja për leje është e parashikueshme, ju mund të kërkonti një njoftim paraprak deri në shtatë ditë përpara për qëllimin e punëmarrësit për të përdorur lejen për arsye sigurie ose shëndetësore. Nëse nevoja për leje nuk është e parashikueshme, ju mund t'i kërkonti punëmarrësit që t'ju njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur (e arsyeshme).

Dokumentacioni

Ju mund të kërkonti dokumentacion përkatës nëse një punëmarrës përdor më shumë se tri ditë pune rresht si leje për arsye sigurie ose shëndetësore. Ju mund të kërkonti:

- një raport mjekësor të nënshkruar nga një ofrues i licencuar i kujdesit shëndetësor; ose
- dokumentacion nga një ofrues i shërbimeve sociale, ofrues i shërbimeve ligjore, anëtar i klerit ose një letër të noterizuar të shkruar nga punëmarrësi ku ai cilëson nevojën e lejes për arsye sigurie.

Ju nuk mund të kërkonti që në dokumentacion të specifikohet motivi i lejes për arsye sigurie ose shëndetësore. Zbulimi i këtyre motiveve mund të kërkohet në bazë të ligjeve të tjera.

Ju duhet të kompensoni punëmarrësit për:

- çdo tarifë që u është vendosur nga ofruesit e kujdesit shëndetësor për të siguruar dokumentacionin e lejes për arsye shëndetësore; dhe
- të gjitha kostot ose shpenzimet e arsyeshme për të siguruar dokumentacionin e lejes për arsye sigurie.

Leja e papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore

Një punëmarrës mund të mbartë në vitin pasues kalendarik deri në 40 orë (ose 56 orë, sipas rastit, nga 1 janari 2021) leje të papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore. Megjithatë, nga ju kërkohet që të lejoni punëmarrësin të përdorë deri në 40 (ose 56) orë leje për arsye sigurie dhe shëndetësore për çdo vit kalendarik.

Ju mund të zgjidhni, ndonëse nuk ju kërkohet, të paguani një punëmarrës për lejen e papërdorur për arsye sigurie dhe shëndetësore në fund të vitit kalendarik. Punëmarrësit nuk mund të mbartin leje për arsye sigurie dhe shëndetësore nëse ju i keni paguar lejen për arsye sigurie dhe shëndetësore DHE nëse ju i ofroni një total orësh të lejes së paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore që përputhet ose tejkalon kërkesat e ligjit për vitin e ri kalendarik në ditën e parë të vitit të ri kalendarik.

Penalizimi

Ju nuk mund të penalizoni punëmarrësit për kërkimin ose marrjen e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore. Penalizimi përfshin çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje në detyrë, pezullim ose reduktim të orëve të punës së punëmarrësit, ose çdo veprim tjetër të pavolitshëm punësimi ndaj një punëmarrësi që e pengon punëmarrësin që të ushtrojë apo të përpiqet të ushtrojë çdo të drejtë të garantuar nga ligji, ku përfshihen masat e lidhura me statusin e perceptuar të emigrimit ose me autorizimin për punë.

Ankesat

Nëse një punëmarrës depoziton një ankesë pranë DCWP-së, DCWP-ja do t'ju kontaktojë për një përgjigje me shkrim. Ju duhet t'i përgjigjeni DCWP-së brenda 14 ditëve, ose ndonjëherë edhe më përpara në varësi të akuzave. DCWP-ja do të bashkëpunojë me ju për zgjidhjen e ankesës.

Njoftim për hetim

Nëse keni marrë një njoftim për hetim, duhet të paraqisni të gjitha informacionet dhe dokumentet e kërkuara. Moszbatimi i këtij udhëzimi mund të përbëjë shkelje të ligjit dhe mund të rezultojë në gjoba krahas sanksioneve civile dhe masave të sigurimit për shkelje të tjera të mundshme. Mungesa e sigurimit të të dhënave mund të ndikojë negativisht në çështjen tuaj në rast se ajo kalon në gjykatën administrative të qytetit. Ju keni mundësi të zgjidhni çdo shkelje jashtë gjykatës ose mund të dilni përpara një gjykatësi të paanshëm në gjykatën administrative të qytetit.

Përditësuar më datë 20.11.2020



Pyetje? Për më shumë informacione ose për të kontaktuar me DCWP-në:

- Vizitoni faqen nyc.gov/workers për ligjin dhe për pyetjet më të shpeshta
- Përdorni Bisedat e drejtpërdrejta, të disponueshme në faqen nyc.gov/BusinessToolbox
- Adresa e email-it: PSSL@dca.nyc.gov
- Telefononi në numrin 311 (212-NEW-YORK jashtë NYC) dhe thoni: "Leje për arsye sigurie dhe shëndetësore"